VENDIM
Nr. 34, datë 13.7.2016

PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT PËR VITIN 2016, PËR DISA PROJEKTE NË VAZHDIM TË GRANTIT "INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE", PROGRAMI I ZHVILLIMIT VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim, me cikël financimi 2015–2016, për grantin "Infrastruktura vendore dhe rajonale", programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1. Lista e disa projekteve me cikël financimi 2015–2016, granti "Infrastruktura vendore dhe rajonale", programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, vazhdimi i financimit për vitin 2016"

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vendimi i KZHR-së	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
	QARKU GJIROKASTËR						
1	Bashkia Gjirokastër	Rikonstruksion i bulevardi "18 shtatori" dhe degëzimeve "Rexhep Qosja" dhe "Gole Gushi"	nr. 39 datë 16.10.2015	258 890 879	25 889 088	139 801 075	93 200 716
	QARKU KORÇË						
2	Bashkia Korçë	Ndërtimi i kompleksit multifunksional, sportiv dhe kulturor	nr. 39 datë 16.10.2015	565 897 319	56 589 732	305 584 552	203 723 035
3	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i rrugës Voskopojë, Lekas, loti I	nr. 39 datë 16.10.2015	35 267 639	3 526 764	31 740 875	-
	TOTALI			**1 025 140 935**	**139 622 793**	**477 126 502**	**296 923 751**

Shënim

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. "Vlera e financimit për vitin 2015" tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

3. "Vlera e financimit për vitin 2016" tregon vlerën që alokohet me këtë vendim, për vitin 2016. Propozimi për financimin e kësaj vlere ka ardhur nga sekretariati teknik (ministri i Zhvillimit Urban), me shkresë nr. 3738, prot., datë 1.7.2016.

4. "Vlera e financimit për vitin 2017" tregon diferencën midis vlerës së projektit me vlerën e kontratës dhe atë të financimit për vitin 2015 dhe 2016. Ky financim, përmbyll financimin e vlerës së kontratës, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Të tria projektet janë në procedurë prokurimi dhe me lidhjen e kontratës për zbatimin e punimeve do të korrektohet edhe vlera e detyrimit për financim, për vitin 2017, në vendimet e radhës së KZHR-së.